



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rrahovec

Skupština Opštine Oraovac / Municipal Assembly Rrahovec

**Komiteti për shëndetësi dhe përkujdesje sociale**  
**PROCESVERBAL**

Mbledhja e komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale është mbajtur me datë **16.09.2022** (e premte) me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e parë e kryesoi anëtari më i vjetër z. **Edmond Kabashi** nga gjithsej pesë (5) anëtarë që janë në këtë komitet. Të gjithë anëtarët ishin prezent në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite;

**REND DITE**

1. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale;
2. Të ndryshme;

**Kryesuesi** – Atëherë përshëndetje për të gjithë, jam Edmond Kabashi – me vendim të kuvendit jam caktuar këtu si ekspert i jashtëm, që të mos t'a zgjasim më shumë, menjëherë të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës;

**1. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale;**

Fillimisht duhet të dakordohemi për mënyrën e zgjedhjes së kryesuesit, janë dy mënyra; me vota të fshehta si dhe me marrëveshje apo me vota direkte me një ngritje të dorës.

Atëherë e vendosim në votim; kush është për?... Me shumicë unanime është vendosur që kryesuesi të jetë me votim të hapur.

Atëherë po i presim propozimet;

**Armir Vuçiterna** – Unë propozoj si kryesuese znj. Vlora Vuçiterna.

**Kryesuesi** – Atëherë nëse propozim tjetër nuk keni, e hedhim në votim propozimin e Armirit, kush është për?... Në mënyrë unanime votohet znj. Vlora Vuçiterna si kryesuese e komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale. Urime.

**2. Të ndryshme;**

**Kryesuesi** – Sa i përket pikës së dytë, nuk kam diçka tjetër, pos asaj që duhet të takohemi dhe të kemi një koordinim për temat e caktuara gjatë këtij mandati.

**Lirigzon Kastrati** – Përshëndetje për të gjithë, te pika të ndryshme mund të flasim dhe të caktojmë një mbledhje në muajin e ardhshëm që edhe kryesuesja e sapo zgjedhur të jetë e gatshme për mbledhje. Faleminderit.

Mbledhja ka përfunduar në ora 10:15

Procesmbajtësi  
  
Albion Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes  
  
Edmond Kabashi  
RAHOC  
ORAOVAC